



Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prudato Received/Delivered	29.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedimca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHUK	4968	/2023	1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.799/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.336/2022, të datës 15.05.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.941/2021, të datës 18.11.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë,

në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.941/2021 e datës 18.11.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datën 24.12.2021 ka nxjerrë Vendimin A.nr.941/2021, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses (tutje vetëm ankuesja) të parashtruar me datën 18.11.2021, kundër organit të punësimit Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë, me pretendimet ankimore lidhur me mos zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.07/29 të datës 31.07.2008 për miratimin e shtesave në paga, për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kundër vendimit të Këshillit. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 15.05.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.336/2022, i cili në Këshill është

pranuar me datën 31.05.2023, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, me ç' rast e ka anuluar Vendimin me numër A.nr.941/2021 të datës 23.12.2021 të KPSHMCK-së duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli si dhe e ka obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankueses.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 18.11.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërim i ankueses me numër Nr.2277 i datës 01.04.2016; Diplomë e ankueses me numër Nr.1462 e datës 15.07.2014; Dëshmi mbi kryerjen e trajnimeve-Certifikatat e ankueses; Vendim me numër Nr.01/39 i datës 08.10.2008 nga Kryeministri i Kosovës; Vendim me numër Nr.02/39 i datës 08.10.2008 nga Kryeministri i Kosovës; Aneksi mbi listën e titujve të punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Kërkesë e datës 20.09.2021 për pagesën e shtesave të TI-së nga ankuesja dhe udhëheqësi i sektorit të TI-së në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; Kërkesë e datës 17.11.2017 për miratimin e shtesave për sektorin e TI-së në AUV; Kërkesë e datës 04.09.2020 për miratimin e shtesave për sektorin e TI-së në AUV; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 02.11.2021 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërim i ankueses me numër Nr.4251/1 i datës 09.06.2021 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, , për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe duke marrë për bazë pikëpamjet juridike sipas Aktgjykimit me numër A.nr.336/2022 të datës 31.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të Akt Emërimit me numër Nr.2277 të datës 01.04.2016, ka konstatuar se ankuesja mban pozitën e punës "*Zyrtare e Teknologjisë Informative*", Sektori i Teknologjisë Informative në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë,

Ankuesja, me datën 17.11.2017 dhe 04.09.2020, përmes Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ka parashtruar kërkesë për miratimin e shtesave të TI-së tek Drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike, mirëpo që e njëjta nuk ka marrë përgjigje. Po ashtu me datën 20.09.2021 ankuesja dhe Udhëheqësi i sektorit të TI-së të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, kanë parashtruar kërkesë për pagesën e shtesave të TI-së për tek zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, e që institucioni AUV-it nuk është përgjigjur rreth kërkesës së tyre.

E pa kënaqur me mos përgjigjen lidhur me kërkesën për miratimin e shtesave të TI-së nga Ministria e Administratës Publike, me datën 18.11.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës në pagën bazë në lartësi prej dyqind (200) euro për pozitën Specialist i TI-së dhe kompensimin në formë retroaktive të kësaj shtese që nga data

01.04.2016 prej edhe kur e ushtron detyrën e zyrtares së TI-së në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Ankuesja në ankesën e saj të parashtruar në Këshill pretendon se: që nga themelimi i marrëdhënies së punës në vitin 2016 nuk ka realizuar shtesat për IT siç përcaktohet me Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Kosovës, duke shtuar me tej se i njëjta i është drejtuar me kërkesë me shkrim institucionit punëdhënës për kompensimin e shtesave të IT-së, por që asnjëherë nuk ka marrë përgjigje në kërkesën e saj. Propozon që Këshill ti njoh te drejtën e kompensimit të shtesave të IT-së për të ardhmen dhe në mënyrë retroaktive nga data e themelimit të marrëdhënies se punës.

Kolegji me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuses, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhënë edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuese për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka konstatuar se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar, ku shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, duke qenë së në riprocedurë kemi rrethana të reja ligjore, përkatësisht kemi ndryshime ligjore përkitazi me sistemin e pagave dhe shtesave të nëpunësve civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti ka hyrë në fuqi më datë 05.02.2023, dhe ku me nenin 45 paragrafin 2 ka përcaktuar se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji"* ndërlidhur me nenin 11 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës ku përcaktohet: *"Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet çdo akt nënligjor dhe dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë rregullore"*, Kolegji i Këshillit ka ardhur në konstatimin se Vendimi me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi bazën e të cilit ankuesja kërkon që t'i aprovohet shtesa në pagë tani më është shfuqizuar dhe mbi këtë bazë ligjore pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit, lidhur me shtesat mbi pagën bazë, konstaton se sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, respektivisht nenit 22 është përcaktuar se: *"1.Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale"*, ndërsa me nenin 24 të këtij ligji janë përcaktuar mënyrat e realizimit të shtesës për kushte të tregut të punës. Rrjedhimisht lidhur me këtë shtesë është miratuar Rregullorja (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës e cila ka përcaktuar hapat procedural të realizimit të kësaj shtesë duke përcaktuar se kush mund të jetë përfitues i saj, ku në nenin 4 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, është përcaktuar se: *"Profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës janë: 4.1.profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative..."*, ndërsa neni 5 i Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, ka përcaktuar dhe kriteret që duhet të

plotësohen për të përfituar shtesën për kushte të tregut të punës për të punësuarit në fushën e teknologjisë informative.

Kolegji i Këshillit, duke ju referuar dispozitave të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, ka konstatuar se me nenin 10 janë përcaktuar procedurat për përfitimin e shtesës për kushte të tregut të punës, respektivisht sipas paragrafit 1 dhe 2 është përcaktuar se: *“1. Për përfitimin e shtesës sipas kësaj Rregulloreje, Ministria përgjegjëse për Financa themelon Komision me mandat tre (3) vjeçar, 2. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore e secilit institucion përgatitë listën e të punësuarve të cilët plotësojnë kriteret e kësaj Rregullore dhe e përcjellë atë tek Komisioni sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje”*, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia Përgjegjëse për Burime Njerëzore e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës duhet që sipas detyrës zyrtare të ndër marr veprimet e nevojshme procedurale sipas dispozitave të lartcekura dhe të përcjellë listën e zyrtarëve që hyjnë në këtë fushë të shtesave tek komisioni përkatës i cili në kuptim të nenit 10 paragrafi 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje ka kompetencë funksionale të bëjë shqyrtimin e kërkesave të tilla. Po ashtu, Kolegji i Këshillit përmes e-mailit të datës 21.02.2023 është njoftuar zyrtarisht nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, se Komisioni i përcaktuar në nenin 10 paragrafin 1 të Rregullores (MFPT) Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, është themeluar përmes vendimit të datës 06.02.2023 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave ligjore si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankueses e datës 18.11.2021 lidhur me pretendimet e saj ankimore për kompensimin e shtesës për zyrtar të teknologjisë Informative sipas Vendimit me shifër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerën 200 Euro nga data 01.04.2016 kur ankuesja kishte themeluar marrëdhënien e punës në pozitën *“Zyrtar për Teknologji Informative”*, është e pabazuar, ngase një akt i tillë është shfuqizuar me nenin 45 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa për mënyrën e realizimit të kësaj shtese sipas dispozitave të reja ligjore, janë dhënë sqarimet e nevojshme si më lartë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna në Aktgjykimin me numër A.nr.336/2022 të datës 31.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka konstatuar se lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës, në mënyrë retroaktive në vlerën e 200 Euro për muaj dhe atë nga periudha 01.04.2016 kur ankuesja kishte themeluar marrëdhënien e punës në pozitën *“Zyrtar për Teknologji Informative”*, Kolegji i këshillit ka gjetur se ankuesja me datë 17.11.2017 dhe 04.09.2020 përmes Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, kishte parashtruar kërkesë tek Drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike për miratimin e shtesave të TI-së mirëpo që e njëjta nuk ka marrë përgjigje. Po ashtu me datën 20.09.2021 ankuesja dhe Udhëheqësi i sektorit të TI-së të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, kanë parashtruar kërkesë tek Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë lidhur me kompensimin e shtesave në pagë për IT bazuar në Vendimin me shifër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mirëpo ankueses nuk i janë realizuar kërkesat e saj sikurse nga shkresat e lëndës konstatohet se e njëjta nuk ka

ndërmarrë asnjë hap procedural ankimor deri me datë 18.11.2021 (data e parashtrimit të ankesës) sikurse përcaktohej me dispozitat e ligjit material, prandaj në kuptim të nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", Kolegji i Këshillit konstatoi se një pretendim i tillë ankimor për kompensimin retroaktiv është i jashtë afatshëm, gjegjësisht edhe për këtë çështje ankesa e ankueses është e pabazuar.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.799/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.